



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 20 qershor 2022

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës; në mbështetje të rregullit 19 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 01/2018; si dhe në mbështetje të Rregullores nr. 02/2022 për punën praktike në Gjykatën Kushtetuese, me qëllim të edukimit profesional në fushën juridike të gjyimit dhe të interpretimit kushtetues, Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës shpall publikisht

SHPREHJEN E INTERESIT për angazhimin e praktikantëve

Pozita: Praktikant

Numri i pozitave: 8 (tetë)

Kohëzgjatja e praktikës: Një (1) vit

Detyrat kryesore

1. Detyrat kryesore të punës së praktikantit janë si në vijim:

- angazhohet në punën e këshilltarëve kushtetues juridik dhe të gjyqtarëve;
- mbledh dhe studion literaturë përkatëse ligjore, informacione dhe dokumente sipas kërkesës nga këshilltarët ligjor dhe nga gjyqtarët;
- përgatit analiza krahasuese nën udhëheqjen e këshilltarëve kushtetues juridik;
- hulumton praktikën dhe vendimet e gjykatave tjera kushtetuese dhe ato të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- mirëmban dhe përditëson shënimet përkatëse të databazave të Gjykatës;
- përkujdeset për fajllimin e dokumentacionit përkatës, skenimit, fotokopjimit të materialeve të nevojshme sipas kërkesës; dhe
- kryen punë të tjera profesionale sipas kërkesës së Kryetarit, Këshilltarit të Parë apo Gjyqtarëve, apo Mbikëqyrësit të praktikantëve.

Kualifikimet dhe aftësitë

1. Të drejtë aplikimi për pozitën e praktikantit kanë të gjithë kandidatët që

- të janë shtetas të Republikës së Kosovës;
- kanë zotësi të plotë për të vepruar;
- zotërojnë njërën nga gjuhët zyrtare në Kosovë si dhe kanë njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze;
- kanë diplomuar në fakultetin juridik në njërin nga universitetet në Kosovë, kanë diplomë të fakultetit juridik të nostrifikuar në Kosovë, ose janë në vitin e fundit të studimeve në fakultetin juridik; dhe
- demonstrojnë shkathtësi solide kompjuterike.

Informata të përgjithshme për kandidatët

Shuma e kompensimit material të praktikantëve do të jetë ekuivalente me pagën minimale në Republikën e Kosovës në vitin e angazhimit të praktikantit;

Para kalimit të afatit kohor për të cilin janë pranuar në Gjykatë, praktikantët i nënshtrohen vlerësimit të njohurive të fituara gjatë punës praktike.

Pas përfundimit të periudhës vlerësuese, praktikanti pajiset me certifikatë me të cilën dëshmohet kryerja e suksesshme e punës praktike në Gjykatë.

Gjykata ofron mundësi të barabarta të angazhimit për gjithë kandidatët aplikues.

Procedura e konkurrimit

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës të Gjykatës, të shoqëruar nga një biografi profesionale, një letër motivuese dhe dokumentacionin përkatës për përgatitjen shkollore. Forma e aplikacionit mund të shkarkohet nga ueb-faqja e Gjykatës Kushtetuese: www.gjk-ks.org

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, duhet të paraqitet nëpërmjet e-mailit, në adresën: <mailto:gjk.burimetnijerezore@gjk-ks.org>

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në ueb-faqen e Gjykatës dhe në tabelën e shpalljeve, duke filluar nga data 20. 06.2022 deri më datën 4.06.2022, që konsiderohet ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Data e fundit për pranimin e aplikacioneve është 4 korrik 2022, deri në ora 16.00.

Shënim:

Aplikacionet që arrijnë pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.